



AKT THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë "ALBANIA DRINK DISTRIBUTION co" SH.P.K.

Sot më datën 19.12.2001, ditën e Martorit

1. Xhafer XhAKO, i biri i Muharremit, lindur në Ersekë më 01.01.1964, dhe banues në Tiranë në adresën Rr."Kongresi i Lushnjes", P. 42, Sh. 1, Ap. 4, me Nr. pasaporte ALB-0034750,

lidhet kjo kontratë me kushtet si më poshtë:

N E N I 1

Personi fizik i sipërpermendur me vullnetin e tij te lire dhe ne pajtim me legjislacionin Shqiptar ,ra dakord te krijojë shoqerine me pergjegjesi te kufizuar (shpk) me emertimin "ALBANIA DRINK DISTRIBUTION co " dhe me kapital themeltar 100000 (një qind mijë) lekë.

Kjo shoqëri e ka qendrën në Tiranë, Rr." Siri Kodra " brenda bllokut te frigoriferit.

Administrator i kësaj shoqërie është z. XHAFER XHAKO

Shoqëria "ALBANIA DRINK DISTRIBUTION co" sh.p.k ka të drejtë të krijojë filialet e saj brenda dhe jashtë vendit dhe në cdo kohë që të cmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovim të organeve kompetente.

N E N I 2

Shoqëria "ALBANIA DRINK DISTRIBUTION co" SH.P.K gëzon statusin e personit juridik.

Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave te kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi. Statuti i shoqërisë i bashkëngjitet kësaj kontrate dhe është pjesë përbërëse e saj.

N E N I 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhe kohe mbi 10 vjet.

Shoqëria e mbaron aktivitetin e saj me kalimin e afatit të parashikuar në këtë kontratë, nëse pronari me vullneti e tij te lire nuk e zgjat këtë afat.

Shoqëria e mbyll aktivitetin e saj edhe para afatit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, nëse për këtë mer vendim pronari i kesaj shoqerie.

N E N I 4

Shoqeria "ALBANIA DRINK DISTRIBUTION co" SH.P.K do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- kryerjen e veprimeve tregtare për import-eksportin e mallrave industriale dhe ushqimorë, si dhe te cdo lloj artikulli tjeter te lejuar nga legjislacioni ne fuqi.
- Shitje me shumice dhe pakice
- aktivitete të tjera të ngjashme me to.

N E N I 5

Kapitali themeltar i kësaj shoqërie është 100 000 (një qind mijë) lekë.

Kapitali i shoqërisë depozitohet në llogarinë e shoqërisë në Bankën e
Tiranë.

N E N I 6

Fitimi neto që do të realizohet nga veprimtaria e kësaj shoqërie do të kalojë në llogarinë e pronarit.

N E N I 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie, kjo shoqëri përgjigjet vetë me kapitalin e saj. Pronari nuk mban përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë, me pasurinë e tij, që nuk bën pjesë në kapitalin e kësaj shoqërie.

N E N I 8

Nuk mund të pranohet në shoqëri si ortak një person tjetër pa pelqimin e pronarit.

Ortaku që dëshiron të shesë pjesën e tij në këtë shoqëri është i detyruar që ofertën e tij për shitje t'ua bëjë ortakëve të tjerë dhe nëse këta të fundit nuk pranojnë blerjen ose nuk japin përgjigje brenda 30 ditëve nga dita e bërjes së ofertës, vetëm atëherë ortakë është i lirë të disponojë pjesën e tij.


N E N I 9

Marrëdhëniet e punës në shoqëri ose në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

N E N I 10

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj.

Xhafer Xhako

Xhafer Xhako


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE
T I R A N E
Nr. 5085 Kol
Nr. Rep


Tirane, me 19.12. 2001

V E R T E T I M

Sot me dt. 19.12.2001 para meje Fatmir Zoloshnja Noter ne qytetin e
Tiranes, u paraqiten z. Xhafer Xhako madhorë, me zotesi te plote per te vepruar,
per identitetin e te cilit u binda pasi pashepasaporten e tij, i cili pasi me
deklaroj se kontrata e mesiperme eshte hartuar me vullnetin e tij te lire e te
plotë e nënshkruan atë para meje dhe unë noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

N O T E R

NOTER
FATMIR ZALOSHINJA
TIRANË





S T A T U T

I SHOQËRISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"ALBANIA DRINK DISTRIBUTION co" SH.P.K.

K R E U I

Dispozitat e Perqjithshme

N E N I 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "ALBANIA DRINK DISTRIBUTION co" SH.P.K. është krijuar sipas kontratës dhe këtij statuti të përpiluar dhe nënshkruar nga:

1. Xhafer XHAKO, i biri i Muharremit, lindur në Ersekë më 01.01.1964, dhe banues në Tiranë në adresën Rr."Kongresi I Lushnjes", P. 42, Sh. 1, Ap. 4, me Nr. pasaporte ALB-0034750, dhe

N E N I 2

Emërtimi i shoqërise është "ALBANIA DRINK DISTRIBUTION co" SH.P.K.

N E N I 3

Shoqëria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti krijohet me mjetet ne pronesi private te themeluesit te saj.

N E N I 4

Shoqëria me përgjegjësi te kufizuar "ALBANIA DRINK DISTRIBUTION co" SH.P.K. ne perputhje me vendimin per krijimin e kesaj shoqërie dhe me legjislacionin shqiptar, rregullon poziten juridike te themeluesit dhe punonjesve ne shoqëri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqërise.

N E N I 5

Shoqëria "ALBANIA DRINK DISTRIBUTION co" SH.P.K. është person juridik shqiptar dhe fiton personalitet juridik qe nga data e regjistrimit ne organet perkatese. Shoqëria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentet e krijimit te saj, kontraten dhe ne kete statut.

N E N I 6

Selia e shoqërisë "ALBANIA DRINK DISTRIBUTION co" SH.P.K. është Rr."Siri Kodra " blloku i magazinave brenda frigoriferit, Tiranë.

N E N I 7



Administrator i shoqërie është z.XHAFER XHAKO.

N E N I 8

Shoqëria ka vullen e saj ne forme drejtkendesh ,dimensione normale, brenda së cilës është shkruar: Shoqëria "ALBANIA DRINK DISTRIBUTION co EXPORT -IMPORT" sh.p.k.Tirane. Albania.

N E N I 9

Shoqëria "ALBANIA DRINK DISTRIBUTION co" SH.P.K. është nje shoqëri tregtare qe ka per objekt dhe qellim kryesor:

- kryerjen e veprimeve tregtare për import-eksportin e mallrave industriale dhe ushqimorë, si dhe te cdo lloj artikulli tjetër te lejuar nga legjislcioni ne fuqi,
- shitje me shumice dhe pakice,
- aktivitete të tjera të ngjashme me to.

N E N I 10

Shoqëria ushtron veprimtarine e vet te percaktuar ne kete statut ne territorin e Republikes se Shqiperise.

Për kryerjen e kesaj veprimtarie shoqëria mund te cele dege, zyra dhe filiale te saj te perfaqesimit brenda vendit dhe jashte tij ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendit ku është hapur.

N E N I 11

Shoqëria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbështetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe te rentabilitetit.

N E N I 12

Pjesëmarrja ne shoqëri nuk i pengon pronarin te kete panvarsi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie. Ortakët qe marrin pjese ne shoqëri nuk i nenshtrohen asaj si persona. Ata nuk pergjigjen per detyrimet e shoqërise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj tej kapitalit themelor ku ata kane marre pjese. Po keshtu as shoqëria nuk pergjigjet per detyrimet e ortakeve te saj.

K R E U II

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 13

Veprimtaria e shoqërise realizohet ne baze te veprimtarise kontabel dhe pasqyrohet ne bilancin e saj.

NENI 14

1. Per te bere te mundur zhvillimin e shoqërise caktohet nje kapital themeltar prej 100 000 lekë.



Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar me ane te neneshkrimeve te pjeseve te kapitalit per kontributet ne para apo ne natyre vihet shenim ne statut. Ketu procedohet nepermjet nje raporti qe i bashkengjitet statutit.

NENI 16

Pjeset e kapitalit themeltar jane plotesisht te transferueshme.

Pjeset e kapitalit mund t'iu transferohen te treteve vetem me miratimin e ortakut te vetem.

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohet me akt noterial.

N E N I 17

Shoqëria ne emer te vet është pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin e objektin e veprimtarise qe ajo kryen.

Shoqëria mund te shese pasuri ose te shfrytezoje te drejta te tjera materiale. Ajo mund te ofroje per garanci edhe pasuri te saj per te marre kredi bankare.

N E N I 18

Shoqëria krijon fonde rezerve ose dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj.

Shoqëria disponon mjetet e veta financiare. Detyrimet eventuale qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj mbulohen nga fondi rezerve, nga fondet e tjera ose nga shumat suplementare qe kur deshirojne mund te derdhen prej ortakeve, ne rastet kur keto detyrime nuk mund te mbulohen nga fondet ekzistuese.

K R E U III

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMIT

N E N I 19

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht viti i pare financiar fillon me ditën e regjistrimit te firmes dhe perfundon me 31. dhjetor.

N E N I 20

Llogarite vjetore inventari, raportet operacionet e veprimtarise se vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga ortaku i vetem. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

N E N I 21

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, mbasi zbriten te gjitha detyrimet si edhe fondet e lena rezerve per nxitjen ekonomike, per investime, per reklamen tregtare etj, i kalojne ortakut te vetem.

N E N I 22

Bilanci vjetor i shoqërise nxirret brenda 31 marsit te vitit pasardhes.

ADMINISTRIMIN E N I 22

Ortaku i vetem i shoqërise e perballojne humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se derdhur ne formimin e kapitalit themeltar.

N E N I 23

Ortaku i vetem i shoqërise mund ti delegoje kopetencat e tij. Vendimet e tij te mara depozitohen ne regjister.

N E N I 24

Shoqëria me pergjegjesi te kufizuar administrohet nga nje ose disa persona fizik. Administratori ka te gjitha kopetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqërise, ne te gjitha rethanat me perjashtim te kopetencave qe ligji ja jep ortakut te vetem ose ortakeve. Administratori shkarkohet me vendi te ortakut te vetem ose ortakeve.

N E N I 25

Administrimi i shoqërise behet nga administratori. Ne shoqërine "ALBANIA DRINK DISTRIBUTION" SH.P.K. si administrator caktohet XHAFFER XHAKO, i cili ne te njejten kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqërise me te tretet me gjithe veprimtarine e saj.

N E N I 26

Kopetencat e administratorit ne shoqëri jane:

- Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqërise.
- Te beje propozimet e nevojshme kur lind nevoja e kapitalit themeltar te shoqërise.
- Te miratoje akte normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqërise duke perfshire kuadrin dhe personelin.
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqërise.
- Te krijoje organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te shoqërise.
- Te propozoje per krijimin e njesive, srukturave si filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te vendit apo jashte shtetit.
- Te pergatise propozimin per pushimin e veprimtarise se shoqërise.
- Te perzgjedhe ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likuidimit.
- Te siguroje zbatimin e perpikte te vendimeve te asamblese se ortakeve.
- Te percaktoje numrin e punonjesve te shoqërise dhe pagat e tyre.

N E N I 27

Kontrolli i shoqërise mund te kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjedhjeje. Ata caktohen nga mbledhja e ortakeve ose nga ortakut i vetem. Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emerimi, ne rast se behet gabim ose behet e pamundur kryerja e detyres.

K R E U VKOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQËRISE

N E N I 28

Afati i veprimtarise se shoqërise është 10 vjet duke filluar nga viti 2001 si vit i pare i veprimtarise.

K R E U VI

MARREDHENIET E PUNES

N E N I 29

Marreveshja e punes ne shoqëri rregullon ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqërise, legjislacionit shqiptar dhe me kete statut.

N E N I 30

Punesimi i punonjesve ne shoqëri behet mbi bazen e kontrates kolektive te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje:

Kushtet dhe menyra e marredhenies se punes.

Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tij ne vendin e punes.

Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes, puna e nates, puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor, festave zyrtare.

Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes.

Pushimet dhe mungesat, te drejtat, detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.

Pushimi i marredhenies se punes.

Paga e punes se punonjesit, shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

N E N I 31

Shoqëria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet e caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

N E N I 32

Per te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqërise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per shqyrtimin e tyre është Gjykata e Rrethit Tirane.

K R E U VII

MBYLLJA E SHOQËRISE

N E N I 33

Veprimtaria e shoqërise mbaron ne afatin e percaktuar ne aktin e themelimit (kontrate dhe statutin). Veprimtaria e shoqërise mund te mbyllet edhe sipas propozimit te bere nga ortaku i vetem kur gjate dy vjeteve te njepasnjeshem veprimtaria e shoqërise nuk rezulton rentabel.

N E N I 34

Likuidimi i shoqerive rregullohet nepermjet dispozitave qe permbahen ne statut.

Shoqëria i jep fund veprimtarise ne castin e miratimit te bilancit te likuidimit.

N E N I 35

Mjetet financiare si dhe cdo pronesi tjeter e fituar si rezultat i veprimtarise se shoqërise kur shoqëria likuidohet, behen prone e ortakut te vetem pasi te jene zbritur dhe bere pagesat per te gjithë kreditoret e shoqërise.

K R E U VIII

DISPOZITAT E FUNDIT

N E N I 36


Te gjitha vendimet e shoqërise regjistrohen ne nje liber te vecante qe mbahen ne seline e shoqërise.

N E N I 37

Ky statut është hartuar sot, me date 19/12/2001 per shoqërinë "ALBANIA DRINK DISTRIBUTION co" SH.P.K

Statuti hartohet ne gjuhen shqipe.

Xhafer Xhako

Xhafer Xhako


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE
T I R A N E
NR. 5096
NR. — Rep

Tirane, me 18.12. 2001

V E R T E T I M

Sot me daten 18.12. 2001, para meje Fatmir Zalloshnja noter: ne qytetin e Tiranës, u paraqit Xhafer Xhako, madhore, me zotesi te plote per te vepruar, per identitetin e te cilit u binda pasi pashe pasaporten e tij, icili pasi deklaroi se statutin e mesiperm e ka hartuar me vullnetin e tij te lire e te plote e nenshkruan atë para meje dhe une noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

N O T E R

NOTER
FATMIR ZALOSH NJA
TIRANË

